



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 147 Prot

Peshkopi, më 14. 10. 2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.87

Date: 11.10.2022

“ Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin GUSHT 2022, familjeve në nevojë që janë përjashtuar nga sistemi për arsye të pikëzimit, duke përdorur fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, I ndryshuar.” ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 87 Datë 11/10/2022

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN GUSHT 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfutimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e dates **11.10.2022** miratoi me 20 vota pro 1 kundër 0 apstenim: 6% e muajit Gusht 2022.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Gusht 2022 **441** familjeve në nevojë me fond **2.033.852** të cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese.
2. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.
3. I bashkangjitet këtij vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësive Administrative.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi u shpall sot më datë 11.10.2022.





NR. 995/1. PROT.  
PESHKOPË  
12.10.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Peshkopi, më 12.10.2022

Lënda : Per vendimin nr. 87, datë 11.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër  
Drejtuar : BASHKISË DIBËR

PESHKOPË

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.87, date 11.10.2022 “Për dhënien e ndihmes ekonomike me fondin deri 6% për muajin gusht 2022”, konstatova se:  
Vendimi objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e tij, veprim që kurdohet bëhet nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturës së posaqme të Bashkisë Dibër që ka paraqitur për miratim projekt aktin për dhënien e ndihmes ekonomike.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të karakterit individual , bëhet sipas parashikimit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

